



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 55
Prishtinë, më 25.1.2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Emilija Rexhepi, Shaip Muja, Murat Hoxha, Haxhi Shala dhe Salih Salihu.

Munguan: Sergjan Popoviq dhe Time Kadrijaj.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 15.12.2016;
3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për 2017;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të përcaktuar të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa ndonjë shtesë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.12.2016

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 28.12.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017

Kryetarja **Duda Balje** lidhur me planin e punës së Komisionit për këtë vit, të hartuar në bazë të strategjisë legjislativë nga Qeveria, konstatoi si vijon:

- Projektligji për zhurmën duhet të procedohet në mbledhje plenare ku mund të shqyrtohen vërejtjet e Komisionit për integritet, përndryshe pa amendamentin 3 ky ligj nuk do të vlente për Kosovën,
- Projektligji për Hade hyn në planin e sivjetmë të Komisionit, për të cilin do të formohet grupi punues (**Shaip Muja** polemizoi me **Adem Salihaj** se ky projektligj do ta ketë fatin njësoj sikurse Ligji për Obiliqin d.m.th. nuk do të zbatohet, prandaj sipas tij më mirë është të bëhet presion rreth realizimit të tantumës për çka ai ka dërguar amendamente në Komisionin për zhvillim ekonomik, mirëpo kryetarja potencoi se ai p/l për miniera e minerale dhe është kthyer në Qeveri nga Komisioni për Zhvillim ekonomik, për këtë arsye **Adem Salihaj** rikonfirmoi se Komisioni ka pasur parasysh të gjitha këto dhe ka marrë vendim me hartua ligjin dhe ta heq obligimin nga vetvetja),
- **Murat Hoxha** propozoi të rekomandohet shtesë në titullin e projektligjit për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit duke ia shtuar edhe fjalën gjeodezistëve, gjithashtu të përfshijë strategjia edhe projektligjin për shpronësime për të cilin ka pasur premtime që menjëherë në këtë fillimit do t'i procedohet Kuvendit, me çka edhe problemi i Hades do të rregullohej. Ai po ashtu propozoi ligjin për Memorialin e Ibrahim Rugovës për të cilin u ndruan mendimet rreth arsyeve, ngase në njërin anë **Shaip Muja** ishte i mendimit se një ligj i tillë doemos do të jetë polemizues, ngase vetëm Memoriali për Adem Jasharin arsyeton veten, kurse të tjerët mund të janë politikisht, apo në mënyra të tjera polemizuese. Me këtë konstatim nuk u pajtua **Adem Salihaj**, i cili po ashtu arsyetoi propozimin e Murat Hoxhës dhe figurën e Ibrahim Rugovës si të pranuar nga gjithë bota demokratike,
- **Salih Salihu** propozoi shtesë për planin e punës duke shtuar hartimin e ligjit për cilësinë e bukës ngase në Kosovë nuk mund të flasim për faktin sa gram duhet të jetë një bukë, e mos të flasim për kualitetet që duhet të përmbajë ajo.

KOMISIONI MIRATOI PLANIN E PUNËS 2017 DHE RAPORTIN E PUNES PER 2016 me plotësime të cilat do të shqyrtohen edhe gjatë dy mbledhjeve të ardhshme, kur do të ftohen dy ministrat e fushës. Komisioni do të mbikëqyrë dy ligje në 6 mujorin e parë (Ligji për ushqimin dhe Ligjin për kadastër).

4. Të ndryshme

Kryetarja, në bazë të vendimit nga mbledhja e kaluar, konfirmoi Nismën e hartimit të **Ligjit për Hade**, për të cilin u formua grupi punues: **Duda Balje-kryesuese, Haxhi Shala, Murat Hoxha** dhe **Adem Salihaj**, anëtarë të grupit punues, gjithashtu edhe për nismën rreth hartimit të **Projektligjit për cilësinë e bukës**, nënkryetari i Komisionit Salih Salihu e arsyetoi, kurse Komisioni miratoi plotësimin e planit të punës, ndërkaq rreth hartimit të **Ligjit për Memorialin e Ibrahim Rugovës**, Komisioni do të vazhdojë diskutimin.

Për mbledhjen e radhës u ftua ministri i Bujqësisë rreth diskutimit të planit të punës në fushën e bujqësisë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje

Stafi Mbështetës i Komisionit.